



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:217876

Datë: 26.12.2024

Numri i dokumentit: 06654311

PPP.nr.14/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditores S.D nga Rahoveci, e përfaqësuar shoqëria e avokatëve “L., me avokatin N.S nga Prishtina, kundër debitorit të përmbarimit Komuna e Rahovecit, në bazë të dokumentit të përmbarues – Vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative me numër 644/2020 i datës 30.06.2020, i marrë nga Inspektorati i Punës i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin të përmbaruesit privat S.K me seli në Suharekë, P.nr.223/20 të datës 10.09.2020, jashtë seancës, me datën 26.12.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET në tërësi i bazuar prapësimi i debitorit të përmbarimit Komuna e Rahovecit, të ushtruar kundër urdhrin për përmbarim, P.nr.223/20 të datës 10.09.2020, të Përmbaruesit privat S.K nga Suhareka, ndërsa SHFUQIZOHET i njëjti urdhër për përmbarim.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit përveç se deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike të përmbarimit, të gjitha shpenzimet e përmbarimit, do t'i bartë ajo palë e cila e humb procesin gjyqësor – përmbarimor.

A r s y e t i m

Sipas propozimit të kreditores së përmbarimit S.D, përmbaruesi privat S.K me seli në Suharekë, ka lejuar përmbarimin sipas urdhrin P.nr.223/20 të datës 10.09.2020, në bazë të dokumentit të përmbarues – Vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative, me numër 644/2020 i datës 30.06.2020, i marrë nga Inspektorati i Punës i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kundër debitorit Komuna e Rahovecit.

Kundër urdhrin me të cilin është caktuar përmbarimi, debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kontestuar urdhrin për caktimin e përmbarimit, pasi që vendimi bashkëngjitur në propozim nuk i plotëson kushtet sipas nenit 27 të LPP-së, për shkak se

dokumenti mbi të cilin është bazuar propozimi për përmbarim i mungojnë vetitë e dokumentit përmbarues, rrjedhimisht është i papërshtatshëm për përmbarim sepse në dokumentin përmbarimor mungon shuma dhe koha e specifikuar për kompensim apo për përmbushjen e detyrimit. E ka kundërshtuar caktimin e ekspertit financiar për shkak se nuk është e caktuar shuma e përgjithshme për pagesën e borxhit, përmbushjen e detyrimit.

Kreditorja, në përgjigjen në prapësim vlerëson se arsyetimi i debitorit në prapësim është kontradiktor sepse vendimi ka shumë, ndërsa për kohën e përmbushjes zbatohet neni 144 par.1, pika 3 e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative sa i përket kohës së përmbushjes dhe konsideron se propozimi për përmbarim është në tërësi në përputhje me dispozitat e LPP-së/

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës, vlerësimi të prapësimi të debitorit, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar.

Në nenin 22 par.1 të LPP-së, në kohën e parashtrimit të këtij propozimi është paraparë se *“Dokumente përmbaruese janë: 1.2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktapajtimi (më tej: ujdia)”*.

Në nenin 23 par.2 të LPP-së parashihet se *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse aktapajtim administrative konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër”*.

Në nenin 27 të LPP-së parashihet se *“1. Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. 2. Në qoftë se me anë të dokumentit përmbarues nuk është caktuar afati për përmbushje vullnetare të detyrimit, afati i tillë do të caktohet me anë të aktvendimit për përmbarimin, dhe urdhrin për përmbarim, për shtatë (7) ditë. 3. Në rastin nga paragrafi 2. i këtij neni, organi përmbarues e cakton përmbarimin e propozuar nëse debitori brenda afatit që i është caktuar për përmbushje vullnetare nuk e përmbushë detyrimin e tij”*.

Në nenin 36 të LPP-së parashihet se *“1. Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri. 2. Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë. 3. Përrjashtimisht nga dispozitat e paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni, dokumenti përmbarimorë i noterit, në bazë të cilit është paraqitur propozimi për përmbarim, nuk ka nevojë të jetë i pajisur me vërtetimin për përmbarueshmërin, por përmbarueshmëria e tij përcaktohet sipas dispozitave të ligjit për noterinë. 4. Vërtetimin për përmbarueshmërin të dhënë pa qenë të plotësuara kushtet e parapara me ligj e anulon me aktvendim e njëjta Gjykatë, respektivisht i njëjti organ i pushtetit sipas propozimit të debitorit. Propozimi për anulim duhet të paraqitet brenda afatit prej shtatë (7) ditë nga dita e dorëzimit të aktvendimit*

përmbaues tek debitori. Organi përmbaues ose organi kompetent shtetëror po ashtu mund ta inicojn anulimin në çdo kohë”.

Gjykata, pasi e analizoi vendimin me numër 644/2020 i datës 30.06.2020, i marrë nga Inspektorati i Punës i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale vlerëson se i njëjti është dorëzuar në origjinal, ndaj të njëjtit është e lejuar ankesa në afat prej 8 ditëve, i njëjti nuk e ka klauzolën se është i plotfuqishëm dhe as klauzolën se është i ekzekutueshëm. Po ashtu i njëjti vendim nuk është as i përshtatshëm për përbarim për shkak se i njëjti nuk e ka të përcaktuar shumën e saktë në pikën II të dispozitivit sa i përket pagesës së shujtave, ndërsa në pjesën tjetër nuk e ka të përcaktuar se për çka paguhet paga jubilarë. Kjo gjykatë vlerëson se në procedurën përbarimore, gjykata nuk ka kompetencë që t’i vlerësojë ditët e pranisë në punë si dhe vitet jubilarë, për shkak se në këtë procedurë vlen parimi i rigorozitetit formal, ashtu që gjykata vetëm mund të vërtetojë se a është i përshtatshëm dokumenti për tu përbaruar apo jo.

Prandaj, gjykata vlerëson se vendimi në të cilin bazohet propozimi për përbarim dhe urdhri përmbaues nuk kanë titull ekzekutiv dhe se nuk plotësohen kushtet ligjore që e bëjnë të përmbaueshëm dokumentin përmbaues, për shkak se nuk dihet koha e përmbushjes së detyrimit monetar, nuk janë të përcaktuara shumat dhe nuk dihet se për cilën periudhë kërkohet shpërblimi jubilar. Po ashtu, këtij dokumenti përbarimor i mungojnë elementet që do ta bënin dokument përbarimor për faktin se ky dokument fillimisht nuk ka klauzolën e përmbaueshmërisë dhe as të ekzekutueshmërisë, të cilat është dashur të verifikohen nga përmbauesi privat që e ka lëshuar urdhrin para se të lejohej përbarimi, e që këtë dokument e bën të mangët, e që në procedurën përbarimore, realizimi përkatësisht ekzekutimi i një urdhri të tillë, nuk është i ligjshëm.

Në bazë të dispozitave të nenit 22, 23, 27, 36, 37, 40, 71 par.1 pika 1.1 dhe nenit 73 të ligjit për procedurën përbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

PPP.nr.14/2024, me datë 26.12.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.